# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-452269**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | OVL e UÇK-së thërret protestë popullore nesër në Prishtinë: Asnjë gjykatë s’e zhbën luftën çlirimtare \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/17/ovl-e-uck-se-therret-proteste-popullore-neser-ne-prishtine-asnje-gjykate-se-zhben-luften-clirimtare/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 12:35:40 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 12:32:04 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2d2e954c6c4bef9134f4bc6988d4ebe8a594aaebb0e0e8d4a9f5728fb1c6ed66` |
| TEKSTI | `f256e8bb57f69fb59455bc2a8ca2a2d806544a3cdaec236fde6294cb2f06e17f` |
| PAMJA | `93cabd65755b0097cc57ff4ba90b1c02e1edc1bcd1501d7c89751494848baee9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5556d5201575b0b5d4d844d008cc6bc83bc9ac576ac3f2e9c3205ee7d93b7dfb` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5556d5201575b0b5d4d844d008cc6bc83bc9ac576ac3f2e9c3205ee7d93b7dfb`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# OVL e UÇK-së thërret protestë popullore nesër në Prishtinë: Asnjë gjykatë s'e zhbën luftën çlirimtare

14:32 : 17/09/2026 në **RAJONI**




Pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka paralajmëruar një protestë gjithëpopullore në Prishtinë.

Lajmi u bë i ditur nga Gazmend Syla, përfaqësues i OVL-së së UÇK-së, gjatë një konference për mediat. Ai njoftoi se protesta do të zhvillohet të premten, në orën 12:00, në sheshin "Skënderbeu", ku pritet të mblidhen qytetarë dhe përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta.

Syla tha se OVL e UÇK-së e kundërshton vendimin e Gjykatës Speciale dhe e cilësoi atë si një goditje ndaj figurave që, sipas tij, përfaqësojnë luftën çlirimtare të Kosovës. Ai theksoi se qëndrimi i organizatës së veteranëve është se lufta e UÇK-së nuk mund të paraqitet si një ndërmarrje kriminale dhe se vendimet gjyqësore nuk mund të ndryshojnë atë që ata e konsiderojnë si historinë e çlirimit të Kosovës.

*"Shprehim indinjatën tonë të thellë për vendimin ndaj krerëve të UÇK-së. UÇK-ja nuk ishte kurrë ndërmarrje kriminale, por rezistenca e popullit tonë. Asnjë vendim nuk mund ta rishkruajë luftën tonë çlirimtare"*, deklaroi Syla.

**Lexo edhe:**

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Berisha: Vuçiç dhe Rama janë përgjegjës direkt për atë që ndodhi në Hagë

Policia paralajmëron protestuesit: Lironi rrugën, do veprojmë

Ai bëri të ditur gjithashtu se organizatat e dala nga lufta e UÇK-së do të ndërmarrin hapa për të koordinuar veprimet e tyre pas vendimit të Gjykatës Speciale. Sipas Sylës, synimi është krijimi i një Këshilli Koordinues Kombëtar dhe hartimi i një platforme të përbashkët, ku të përfshihen përfaqësues nga Kosova,

Shqipëria, shqiptarët në Maqedoninë e Veriut dhe mërgata shqiptare.

Syla tha se kjo nismë synon të krijojë një qëndrim të koordinuar në periudhën në vijim, veçanërisht deri në shqyrtimin e çështjes në Apel. *"Deri në procesin e Apelit kërkojmë*

**TË GJITHA**


OVL e UÇK-së thërret protestë popullore nesër në Prishtinë: Asnjë gjykatë s'e zhbën luftën çlirimtare
14:32 : 17/09/2026


A do ta lëshojë PS nëse SPAK kërkon sërish arrestimin? Berisha: Qeveria sot është Balluku-Rama
14:16 : 17/09/2026


Berisha-Spahiut: U betove për të mbrojtur aktet korruptive në shëndetësi, jep dorëheqjen sa më parë
14:12 : 17/09/2026


16 vjedhje brenda dy muajve në Tiranë, arrestohet 'skifteri'. Thyente dyert dhe grabiste lokalet (Video)
14:04 : 17/09/2026


Tabaku: Kuvendi rrëzoi komisionin për KAYO-n, PD do ta çojë çështjen në Kushtetuese
13:57 : 17/09/2026


Sherri me thika ku u plagosën dy vëllezër, tre të arrestuar në Sarandë
13:45 : 17/09/2026


Zbulohet skema/ Meteo dhe Ulza dyshohen për marrëveshje të fshehtë në tenderin 2.8 mln euro
13:44 : 17/09/2026

*përfshirjen e institucioneve tona në këtë drejtim”*, u shpreh ai.

Në vijim të deklaratës së tij, përfaqësuesi i OVL-së njoftoi edhe për një tjetër aktivitet që do të zhvillohet gjatë ditës së sotme në Prishtinë. Ai tha se në orën 16:30 do të prezantohet platforma e re dhe më pas përfaqësuesit e shoqatave do t’u bashkohen studentëve që ndodhen në shesh.

Protesta e së premtes është thirrur në një moment kur në Kosovë ka reagime të shumta pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë. OVL e UÇK-së u ka bërë thirrje qytetarëve që t’i bashkohen tubimit në sheshin “Skënderbeu”, ndërsa paralajmëron se shoqatat e dala nga lufta do të vazhdojnë koordinimin e tyre edhe në ditët në vijim.

**Etiketa:** proteste uck

## Lajme të lidhura



**Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Berisha: Vuçiç dhe Rama janë përgjegjës direkt për atë që ndodhi në Hagë**

12:55 : 17/09/2026



**Policia paralajmëron protestuesit: Lironi rrugën, do veprojmë**

12:27 : 17/09/2026



**Eksperti i së drejtës ndërkombëtare: Aktgjykimi mund të sfidohet si në fakte, ashtu edhe në ligj**

12:07 : 17/09/2026



**Përshkallëzon protesta jashtë Kuvendit, qytetarët godasin me vezë efektivët e policisë**

11:35 : 17/09/2026



**Seancë plenare dhe protestë, policia rrethon Parlamentin dhe vendos gardh metalik**

09:06 : 17/09/2026



**Censurë, IA dhe deepfake: Lufta online rreth ‘Revolucionit të Flamingove’**

08:23 : 17/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto: [email protected]

NA NDIQ

2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.